



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

CHECK AGAINST DELIVERY

Shkup, 21 janar 2013

**Premierë e një filmi dokumentar "IN/Visible City"
(projekt i financuar në suaza të Programit Kulturor 2007-
2013)
[MOB]**

Fjalim
Ambasadori Aivo Orav
Shef i Delegacionit të BE-së

**E nderuara Ministreshë Kançeska-Milevska,
E nderuara Ambasadore, zj. Shurman,
E nderuara zj. Popllavska,
Zonaj dhe zotërinj,**

Kam kënaqësinë të jem këtu me ju sonte, në premierën zyrtare të filmit dokumentar artistik *In/Visible City (Qyteti i Pa/Dukshëm)*, i financuar në suaza të Programit Kulturor të Bashkimit Evropian.

Programi Kulturor ofron ndihmë për iniciativat që lartësojnë shumëllojshmërinë kulturore të Evropës dhe shtojnë trashëgiminë tonë të përbashkët kulturore, me anë të zhvillimit të bashkëpunimit ndërkufitar mes operatorëve kulturorë dhe institucioneve, qytetarëve, organizatave joqeveritare, dhe administartave nacionale, të cilët marrin pjesë në këtë Program.

Kultura evropiane nënkupton një shoqëri ku grupet e ndryshme etnike, fetare, kulturore dhe grupet e tjera mund të ruajnë identitetin e tyre dhe të kenë ndjenjën e përkatësisë, e cila i bën ata më të hapur ndaj shumëllojshmërisë dhe më fleksibilë në pranimin e saj.

Me përkrahjen e këtij projekti, ne synuam të promovojmë vlerën evropiane të të pasurit shoqëri që njohin potencialin e të gjithë qytetarëve të vet, duke i inkurajuar ata të që të integrohen në

shoqëri dhe të jenë pjesëmarrës aktivë në çështjet sociale, kulturore, ekonomike dhe politike.

Me kënaqësi pres të shoh filmin dokumentar dhe të bindem se të gjithë partnerët e projektit kanë arritur sukses siç u tha më lartë.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj.